



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

RAPORT MONITORIMI

MBI PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI PËR VITIN 2025

ZHVILLUAR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 02.12.2024

Hyrje

Avokati i Popullit, si institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë, për mbrojtjen, parandalimin e shkeljes dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, e ka vlerësuar Reformën në Drejtësi, si reformën më të rëndësishme për ecurinë dhe zhvillimin e sistemit demokratik në Shqipëri. Kjo reformë ka një fokus të veçantë në punën e institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm për shkak të detyrimeve ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, por edhe për shkak të vetë rëndësisë që mbart kjo reformë, e lidhur drejtpërdrejtë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në vend.

Në ushtrim të mandatit dhe detyrave bazë që i janë dhënë nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera në fuqi, Avokatit të Popullit i janë dhënë kompetenca mjaft të rëndësishme për monitorimin e zbatimit të Reformës në Drejtësi. Duke qenë se Avokati i Popullit e konsideron si jetësore për të gjithë shoqërinë shqiptare kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë në vend, ka dhënë dhe vazhdon të japë kontributin e tij në shumë prej proceseve, të nevojshme për t'u realizuar. Një vend të rëndësishëm në këto procese zë roli kushtetues i Avokatit të Popullit, në vëzhgimin aktiv dhe proaktiv të veprimtarisë së institucioneve që zhvillojnë procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (më poshtë KED), si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së këtij institucioni, në të gjithë aktivitetin e tij. Ky rol përbën një garanci të shtuar, për transparencën dhe rritjen e besueshmërisë së KED, si një prej organeve të krijuara për funksionimin dhe qeverisjen e sistemit të drejtësisë.

Nën përgjegjësinë e lartë të këtij angazhimi institucional, vlerësojmë se pjesëmarrja dhe monitorimi i procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED dhe për më tepër vlerësimi i raporteve të monitorimit të përgatitura nga ana e Avokatit të Popullit, duhet të konsiderohen si pjesë e sistemit “*check and balance*” dhe të trajtohen problematikat, kur është rasti, në kuadër të veprimtarisë së organeve që kanë përgjegjësinë dhe detyrimin e mbarëvajtjes së procesit të hedhjes së shortit, për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, funksionimi i sistemit të drejtësisë vazhdon të përballet me disa vështirësi. Kjo pasi Reforma në Drejtësi, ka rritur volumin e punës në sistemin e drejtësisë, për shkak të largimeve dhe mungesave të një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh dhe moszëvendësimit të tyre me shpjetësinë e nevojshme. Procesi i vetingut vazhdon me ritme të ngadalta dhe sfida të mëdha sociale dhe profesionale.

Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë gjatë vitit 2024, arritën të ushtrorjnë veprimtarinë e tyre me numër të plotë anëtarësh (pas disa vitesh mungesa), ndërkohë që vazhdon të paraqitet e vështirë situata në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe atyre të Apelit. Riorganizimi i Gjykatave të Apelit (veçanërisht Gjykatat Administrative të Apelit), ka sjellë sfida të reja të cilat duhen adresuar sa më parë.

Duke qenë se në vitin 2016 kur u konceptua përbërja e organit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, harta gjyqësore dhe shpërndarja e gjyqtarëve në gjykata, ishte e ndryshme nga kjo e sotmja, një rishikimi i përfaqësimit dhe përbërjes së KED në kushtet e reja, mund të jetë gjithashtu një opsion.

Në vijim, po paraqesim raportin e monitorimit për procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të ushtrojë veprimtarinë gjatë vitit 2024, të zhvilluar në datën 02.12.2024, në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

1. Kompetenca e Avokatit të Popullit, për monitorimin e procedurës së shortit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Lidhur me procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, parashikon në pikën 3, të nenit 149/d dhe pikën 11, të nenit 179 (dispozitat kalimtare dhe të fundit), ndër të tjera se: *“Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED)¹... Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 Dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 Dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.*

“Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Po kështu, në pikën 6, të nenit 284, të ligjit nr.115/2016 *“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”*, parashikohet se: *“Presidenti i Republikës organizon shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi pa vonesë. Procedurat e shortit dokumentohen nga Presidenti i Republikës. Procedurat e shortit zhvillohen në prani të Avokatit të Popullit, i cili harton dhe bën publik një raport monitorimi mbi procedurën e shortit”.*

Përdorimi i terminologjisë “vëzhgues” dhe “merr pjesë”, për përcaktimin e kompetencës që Avokati i Popullit ka në procesin e krijimit dhe funksionimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, është një çështje e rëndësishme pasi roli i vëzhguesit është minimumi i kompetencës që Avokati i Popullit, i njihet në këtë kuptim, në raport me organin e pavarur të KED. Ligji nr. 115/2016 *“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”*, i ka detajuar përcaktimet e dhëna më sipër

¹ Sipas nenit 149/d, pika 1, të Kushtetutës përcaktohet se: *“Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati”*.

në Kushtetutë, duke qartësuar se Avokati i Popullit ka rolin dhe kompetencën e vëzhguesit, vetëm për procesin e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të KED-së.

Objekti i veprimtarisë së KED, si një prej organeve shtetërore më të rëndësishme për qeverisjen e sistemit të drejtësisë, në përputhje me nenin 149/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, lidhet me verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. KED-ja me cilësinë e një organi kolegjal, përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 221/1, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ata ushtrojnë detyrën me një mandat një vjeçar, që fillon në datën 1 Janar, të çdo viti kalendarik.

Përbërja e KED përcaktohet në nenin 220, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si vijon:

- 2 (dy) gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,
- 1 (një) gjyqtar i Gjykatës së Lartë,
- 1 (një) prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme,
- 2 (dy) gjyqtarë nga Gjykatat e Apelit,
- 2 (dy) prokurorë nga zyrat e prokurorisë, pranë Gjykatave të Apelit,
- 1 (një) gjyqtar nga Gjykatat Administrative.

Sipas pikës 3, të nenit 220, dhe sipas pikës 7, të nenit 221, po të të njëjtit ligj, krahas anëtarëve të KED, zgjidhen edhe anëtarët zëvendësues të tyre, që zëvendësojnë të parët, në rast pamundësie ushtrimi të funksionit, ose në rast të konfliktit të interesit.

Presidenti i Republikës në ushtrim të kompetencës së tij, parësore kushtetuese dhe ligjore, për zhvillimin e procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, midis datave 1 dhe 5 Dhjetor të çdo viti kalendarik, në respektim të afatit përcaktues kohor zhvilloi këtë proces, në datën 02.12.2024. Më konkretisht Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka nxjerrë Vendimin nr. 14, datë 18.11.2024 “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit, nga Presidenti i Republikës, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”², duke caktuar zhvillimin e procedurës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në datën 2 dhjetor 2024, ora 09.00, në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

² <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi-i-Presidentit-te-Republikes-nr.-14-date-18.11.2024-per-hedhjen-e-shortit.pdf>

Vendimi i sipërcituar dhe dokumentet e tjerë zyrtare, të nevojshme për realizimin e procesit të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025, janë bërë publike, në njoftimin zyrtar të publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës, në rubrikën “Hedhja e shortit për KED – Shorti për KED 2025”, para kryerjes së procesit të hedhjes së shortit.³ Në respektim të parimit të transparencës për realizimin e procesit, vlerësojmë se këto njoftime publike të kryera nga ana e Presidentit të Republikës, i kanë shërbyer këtij qëllimi, duke kontribuar gjithashtu në garantimin e ligjshmërisë, seriozitetit dhe besimit të publikut në këtë proces.

Në rubrikën e mësipërme të faqes zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës, janë publikuar gjithashtu edhe të gjitha dokumentet zyrtare që vërtetojnë kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, mbi bazën e të cilave është organizuar shorti, si dhe dokumentacioni i përcjellë nga institucionet e ngarkuara nga ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, për dërgimin e listave me emrat e kandidatëve, për anëtarë të KED-së.

Njoftimi zyrtar për caktimin e një përfaqësuesi për të qenë të pranishëm në momentin e organizimit të shortit i është dërguar:

- Avokatit të Popullit, zj. Erinda Ballanca⁴, Gjykatës Kushtetuese⁵, Këshillit të Lartë Gjyqësor⁶, si dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë⁷;
- Kuvendit të Republikës së Shqipërisë⁸;
- Delegacionit të Bashkimit Europian dhe Ambasadës Amerikane në Tiranë⁹.

Procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025, është kryer gjithashtu në përputhje edhe me: Rregulloren “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”¹⁰; Vendimin e Presidentit të Republikës nr. 14, datë 18.11.2024 “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit, nga Presidenti

³ <https://president.al/hedhja-e-shortit-per-ked/shorti-per-ked-2025/>

⁴ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-caktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-Gjykates-Kushtetuese.pdf>

⁵ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-caktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-Gjykates-Kushtetuese.pdf>

⁶ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-caktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-KLGJ.pdf>

⁷ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-caktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-KLP.pdf>

⁸ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-caktim-perfaqesuesish-nga-Kuvendi-i-Republikes-se-Shqiperise-ne-hedhjen-e-shortit-KED-2025.pdf>

⁹ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Ftese-Delegacionit-te-Bashkimit-Evropian-ne-Tirane-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025.pdf>

¹⁰ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Rregullorja-mbi-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-vendim-nr.-404-date-25.11.2019.pdf>

i Republikës, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, të cilat gjenden të publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës.

Avokati i Popullit ka kompetenca të mirëpërcaktuara në këtë proces, të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga ligji nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, lidhur me: a. Monitorimin (vëzhgimin) e procedurës së hedhjes së shortit, për përzgjedhjen e anëtarëve të KED, nga ana e Presidentit të Republikës; b. Pjesëmarrjen si vëzhgues në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Qëndrimi institucional i Avokatit të Popullit është se, parimet e transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit të përcaktuara në pikën 9, të nenit 221, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, duhet të jenë efektive për të bërë të mundur si përcaktimin e kandidatëve të cilët do t’i nënshtrohen shortimit, ashtu edhe procedurën e shortimit të kandidatëve për t’u bërë anëtarë. Kjo do të thotë se procesi fillon dhe zhvillohet efektivisht, jo vetëm mbi bazën e njoftimeve dhe nisjes së procedurave përkatëse ligjore nga ana e Presidentit të Republikës, por ai bazohet edhe në seriozitetin dhe integritetin moral dhe profesional, të emrave të propozuar si kandidatura për anëtarë të KED-së, nga ana e institucioneve përgjegjëse që kanë këtë detyrim, me qëllim që ky proces të jetë sa më përmbajtësor dhe në përmbushje të plotë, të kritereve të përcaktuara në ligj.

2. Përmbushja e kritereve ligjore nga kandidatët

Neni 221, pika 1, e ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, përcakton përkatësisht tetë kritere ligjore, që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025.¹¹

¹¹ Neni 221:

1. Mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm ata magjistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) në kohën e hedhjes së shortit magjistrati e ka ushtruar funksionin për të paktën 10 vjet dhe anëtari i Gjykatës Kushtetuese për të paktën 1 vit;
- b) nuk ka një masë disiplinore në fuqi;
- c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;
- ç) magjistrati ka përfunduar ciklin e plotë katër ose pesëvjeçar të studimeve në drejtësi;
- d) magjistrati ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- dh) magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etik dhe profesional;
- e) magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ë) magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

2. Kandidatët që nuk plotësojnë një nga këto kushte përjashtohen nga shorti

Në njoftimin zyrtar të publikuar në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës, nënvizohet kjo kërkesë bazike për vlefshmërinë e procesit. Ndër të tjera në këtë njoftim parashikohet shprehimisht se: “...sipas ligjit do të përfshihen në short për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ata magjistratë (gjyqtarë dhe prokurorë) dhe Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, plotësojnë kushtet e parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj”.

Në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës¹², janë publikuar dokumentet zyrtare që lidhen me këtë proces, si vijon:

- Vendim nr. 14, datë 18.11.2024 “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit, nga Presidenti i Republikës, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”¹³
- Vendim nr. 404 datë 25.11.2019 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”¹⁴
- Urdhër nr. 66, datë 19.11.2024 “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik, për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”¹⁵
- Shkresë nr. prot. 3866, datë 05.11.2024 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të procedurës për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë¹⁶
- Shkresë nr. prot. 3867, datë 05.11.2024 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të procedurës për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor¹⁷
- Shkresë nr. prot. 3868, datë 05.11.2024 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të procedurës për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, drejtuar Gjykatës Kushtetuese¹⁸

¹² <https://president.al/hedhja-e-shortit-per-ked/shorti-per-ked-2025/>

¹³ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi-i-Presidentit-te-Republikes-nr.-14-date-18.11.2024-per-hedhjen-e-shortit.pdf>

¹⁴ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Rregullorja-mbi-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-vendim-nr.-404-date-25.11.2019.pdf>

¹⁵ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Urdher-i-Sekretarit-te-Pergjithshem-per-ngritjen-e-Sekretariatit.pdf>

¹⁶ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kerkese-per-bashkepunim-drejtuar-institucioneve-mbi-dergimin-e-listave.pdf>

¹⁷ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kerkese-per-bashkepunim-drejtuar-institucioneve-mbi-dergimin-e-listave.pdf>

¹⁸ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kerkese-per-bashkepunim-drejtuar-institucioneve-mbi-dergimin-e-listave.pdf>

- Shkresë nr. prot. 4043/4, datë 19.11.2024 me lëndë “Njoftim për organizimin e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, drejtuar Avokatit të Popullit¹⁹
- Shkresë nr. prot. 4043/6, datë 19.11.2024 me lëndë “Njoftim për caktimin e një përfaqësuesi për të qenë i pranishëm në momentin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, drejtuar Gjykatës Kushtetuese²⁰
- Shkresë nr. prot. 4043/7, datë 19.11.2024 me lëndë “Njoftim për caktimin e një përfaqësuesi për të qenë i pranishëm në momentin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, drejtuar Këshillit të Lartë të Gjyqësor²¹
- Shkresë nr. prot. 4043/8, datë 19.11.2024 me lëndë “Njoftim për caktimin e një përfaqësuesi për të qenë i pranishëm në momentin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë²²
- Shkresë nr. prot. 4043/9, datë 19.11.2024 me lëndë “Njoftim për caktimin e një përfaqësuesi për të qenë i pranishëm në momentin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë²³
- Shkresë nr. prot. 4043/10, datë 19.11.2024 me lëndë “Kërkesë për grup xhirimi”, drejtuar Radio - Televizionit Publik Shqiptar²⁴
- Shkresë nr. prot. 4043/2, datë 19.11.2024 me lëndë “Autorizim”, e Presidentit të Republikës së Shqipërisë²⁵
- Shkresë nr. prot. 4043/3, datë 19.11.2024 me lëndë “Përcillet ftesa për pjesëmarrje në organizimin e hedhjes së shortit Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, drejtuar Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë²⁶

¹⁹ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-aktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-Avokatit-te-Popullit.pdf>

²⁰ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-aktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-Gjykates-Kushtetuese.pdf>

²¹ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-aktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-KLGJ.pdf>

²² <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-aktim-perfaqesuesi-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025-drejtuar-KLP.pdf>

²³ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Njoftim-per-aktim-perfaqesuesish-nga-Kuvendi-i-Republikes-se-Shqiperise-ne-hedhjen-e-shortit-KED-2025.pdf>

²⁴ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kerkese-per-grup-xhirimi.pdf>

²⁵ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Autorizim-i-Presidentit-te-Republikes-per-moderimin-e-shortit-per-KED-2025.pdf>

²⁶ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Ftese-Delegacionit-te-Bashkimit-Evropian-ne-Tirane-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025.pdf>

- Shkresë nr. prot. 4043/5, datë 19.11.2024 me lëndë “Përcillet ftesa për pjesëmarrje në organizimin e hedhjes së shortit Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, drejtuar Ambasadës së SHBA-së në Tiranë²⁷
- Shkresë nr. prot. 5254/3, datë 05.11.2024 me lëndë “Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, e Gjykatës Kushtetuese, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë²⁸
- Shkresë nr. prot. 960/1, datë 19.11.2024 me lëndë “Ridërgim i listës me emrat e magistratëve (gjqtarë), të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara me ligj për t’u përfshirë në shortin për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, e Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë²⁹
- Shkresë nr. prot. 2512/1, datë 11.11.2024 me lëndë “Dërgohet lista e prokurorëve, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriterit për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë³⁰
- Shkresë nr. prot. 1000/1, datë 20.11.2024 me lëndë “Caktim përfaqësuesi për të qenë i pranishëm në momentin e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së”, e Gjykatës Kushtetuese, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë³¹
- Shkresë nr. prot. 4043/13, datë 21.11.2024 me lëndë “Kërkesë për informacion mbi përditësimin e të dhënave për kandidatët për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (2025)”, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë³²
- Shkresë nr. prot. 5646/1, datë 21.11.2024 me lëndë “Kthim pergjigje “Mbi caktimin e përfaqësuesit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, e Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë³³
- Shkresë nr. prot. 5354/6, datë 26.11.2024 me lëndë “Kthim pergjigje, e Këshillit të Lartë Gjyqësor, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë³⁴

²⁷ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Ftese-Ambasades-se-Shteteve-te-Bashkuara-te-Amerikes-per-pjesemarrje-ne-organizimin-e-hedhjes-se-shortit-KED-2025.pdf>

²⁸ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Lista-e-kandidateve-e-percjelle-nga-Gjykata-Kushtetuese.pdf>

²⁹ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Lista-e-kandidateve-e-percjelle-nga-KLGJ.pdf>

³⁰ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Lista-e-kandidateve-e-percjelle-nga-KLP.pdf>

³¹ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Caktim-i-perfaqesuesit-te-Gjykates-Kushtetuese-per-pjesemarrje-ne-hedhjen-e-shortit-KED-2025.pdf>

³² <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kerkese-per-informacion-mbi-perditesimin-e-te-dhenave-pe-kandidatet-per-hedhjen-e-shortit-per-zgjedhjen-e-anetareve-te-KED-2025.pdf>

³³ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Caktim-i-perfaqesuesit-te-Keshillit-te-Larte-Gjyqesor-per-pjesemarrje-ne-hedhjen-e-shortit-KED-2025.pdf>

³⁴ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kthim-pergjigjeje-ne-lidhje-me-listat-e-perditesuara-te-kandidateve-nga-KLGJ.pdf>

- Shkresë nr. prot. 4393/2, datë 27.11.2024 me lëndë “Njoftim për caktimin e përfaqësuesve të Kuvendit” e Kuvendit të Shqipërisë, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë³⁵
- Shkresë nr. prot. 2587/1, datë 27.11.2024 me lëndë “Për caktimin e përfaqësuesit në procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2025”, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë³⁶
- Shkresë nr. prot. 2599/1, datë 27.11.2024 me lëndë “Ridërgim i listës së magistratëve prokurorë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë³⁷
- Shkresë nr. prot. 553/1, datë 27.11.2024 me lëndë “Njoftim mbi pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit, si vëzhgues në hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2025”, e Avokatit të Popullit, drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë³⁸
- Shkresë nr. prot. 4043/21, datë 02.12.2024 “Shpallja e rezultatit pas hedhjes së shortit nga Presidenti i Republikës”³⁹
- Shkresë nr. prot. 4043/22, datë 02.12.2024 “Procesverbal: Rezultati i shortit të hedhur për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë për vitin 2025”, i institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë⁴⁰

Nga korespondenca e zhvilluar ndërmjet institucionit të Presidencës, me institucionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), rezultojnë se KLGJ dhe KLP kanë kryer verifikimin paraprak të kushteve dhe kriterëve të kandidatëve, si dhe kanë publikuar në faqet zyrtare respektive të internetit, emrat e gjyqtarëve dhe prokurorëve që i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë kandidatë dhe atyre që nuk i plotësojnë.

Ndërkohë KLGJ në shkresën e saj, informon se pas komunikimit me Gjykatën Administrative të Apelit, rezultojnë se nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit asnjë prej gjyqtarëve për kundërshtimin e vendimit të KLGJ-së, për përjashtimin nga lista e kandidatëve për shortin për anëtarë të KED-së.

³⁵ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Caktim-i-perfaqesuesve-nga-Kuvendi-i-Republikes-se-Shqiperise-per-pjesemarrje-ne-hedhjen-e-shortit-KED-2025.pdf>

³⁶ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Caktim-i-perfaqesuesit-te-Keshillit-te-Larte-te-Prokurorise-per-pjesemarrje-ne-hedhjen-e-shortit-KED-2025.pdf>

³⁷ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kthim-pergjigjeje-ne-lidhje-me-listat-e-perditesuara-te-kandidateve-nga-KLP.pdf>

³⁸ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/12/Caktimi-i-perfaqesuesit-te-Avokatit-te-Popullit-per-pjesemarrje-ne-hedhjen-e-shortit-KED-2025.pdf>

³⁹ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/12/Shpallja-e-rezultatit-pas-hedhjes-se-shortit-nga-Presidenti-i-Republikes-sot-me-2-dhjetor-2024.pdf>

⁴⁰ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/12/Procesverbali-i-rezultatit-te-shortit-KED-2025.pdf>

Po kështu informon se ka një ndryshim në listën emërore të përcjellë pasi në kushtet kur magjistrati (gjyqtar) z. Darjel Sina ka ndërruar jetë, ai është zëvendësuar.

3. Monitorimi i hedhjes së shortit

Procesi i hedhjes së shortit për anëtarë të KED, filloi në orën 09.00, të datës 2 dhjetor 2024, në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, salla “Skënderbej”. Në këtë sallë janë paraqitur dhe kanë qenë prezent gjatë gjithë zhvillimit të procedurës të hedhjes së shortit, përfaqësues nga institucione shtetërore si vijon: Avokati i Popullit, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Po kështu ishin të pranishëm edhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare që kanë asistuar dhe ndjekur jo vetëm Reformën në Drejtësi, por edhe punën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi: më konkretisht përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë, si dhe Ambasada Amerikane në Tiranë (këshilltarja ligjore rezidente pranë misionit OPDAT).

Prezent në ambientin ku po zhvillohej shorti, ka qenë edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj, i cili ka qëndruar gjatë gjithë zhvillimit të këtij procesi.

Në përputhje me parashikimet e Rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, Presidenti i Republikës kishte ngarkuar zj. Erjola Shia drejtor i shërbimeve juridike në institucionin e Presidencës, për moderimin e procedurës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve.⁴¹

Procesi i zhvillimit të shortit u drejtua dhe moderua nga zj. Erjola Shia, e cila fillimisht bëri një prezantim të shkurtër të rëndësisë së KED-së, procedurave të krijimit të tij, përbërjes, kompetencave që i jepen nga Kushtetuta dhe nga legjislacioni në fuqi, si dhe të kriterëve ligjore që duhet të përmbushë çdo kandidat deri në momentin e hedhjes së shortit, për t’u përfshirë në këtë të fundit.

Për verifikimin fizik të goglave plastike me të cilat do të hidhej shorti për zgjedhjen e anëtarëve të KED, si dhe mjeteve të tjera (enë qelqi ku futeshin goglat plastike, enët e qelqit ku do futeshin goglat me emrat e kandidatëve), zj. Shia ftoi Avokatin e Popullit zj. Erinda Ballanca, e cila pasi kreu kontrollin përkatës, deklaroi publikisht se gjithçka ishte në rregull.

Për hedhjen e shortit, mbi bazën e nenit 3 të Vendim nr. 14, datë 18.11.2024, të nxjerrë nga ana e Presidentit të Republikës, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të Presidentit të Republikës, kishte nxjerrë Urdhër nr. 66, datë 19.11.2024 “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik, për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në

⁴¹ Në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës, është publikuar Autorizimi i Presidentit nr. 4043/2, datë 19.11.2024 “Për hedhjen e shortit” (<https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Autorizim-i-Presidentit-te-Republikes-per-moderimin-e-shortit-per-KED-2025.pdf>)

Drejtësi”, duke caktuar në përbërje të Sekretariat 4 (katër) nëpunësve të këtij institucioni dhe 2 (dy) anëtarë zevendësues.

Për hedhjen e shortit u përdorën disa enë qelqi transparente, ku ishin të vendosura goglat sipas numrit të kandidaturave të dërguara në shkresat përkatëse të institucioneve shtetërore propozuese. Gjithashtu u përdor një kuti transparente me mekanizëm rrotullues (e cila fillimisht ishte bosh), ku vendoseshin goglat në të cilat ishin futur shiritat e letrës të shënuara me emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion, sipas listës përkatëse të përcjellë Presidentit të Republikës së Shqipërisë, prej tyre.

Fillimisht shiritat e letrës me emrat e kandidatëve sipas institucioneve përkatëse që merrnin pjesë në short, ishin vendosur në një kuti transparente të veçantë. Procesi teknik i hedhjes së shortit u krye nga dy pjesëtarë të Sekretarisë Teknike (që siç përmendëm përbëhej nga punonjësit e institucionit të Presidentit të Republikës), të cilët kryenin pikërisht veprimet teknike të sipërcituara.

Shiritat e letrës me emrat e kandidatëve pasi u lexuan publikisht, edhe në praninë e mediave, u futën në gogla dhe rradha e hedhjes së shortit u përcaktua duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:

- Kandidatë nga Gjykata Kushtetuese
- Kandidatë nga Gjykata e Lartë;
- Kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme.
- Kandidatë nga Gjykatat e Apelit;
- Kandidatë nga Zyrat e Prokurorisë, pranë Gjykatave të Apelit;
- Kandidatë nga Gjykatat Administrative.

- *Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata Kushtetuese u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të kësaj gjykate, të konfirmuar në listën nominale, të dërguar me shkresën nr. 960/1, datë 05.11.2024 të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, drejtuar Presidentit të Republikës.*⁴² Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Kushtetuese (8 (tetë) kandidatë sipas listës përkatëse), punonjësja e Sekretarisë Teknike të institucionit të Presidentit të Republikës, bëri përzierjen e goglave dhe drejtuesi i procesit teknik të hedhjes së shortit zj. Shia, ftoi Avokatin e Popullit zj. Erinda Ballanca, e cila tërhoqi gogllën përkatëse, nxorri shiritin e letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, lexoi me zë të lartë emrin e kandidatit për të gjithë pjesëmarrësit në sallë dhe më pas ja dorëzoi shiritin e letrës Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 8 (tetë) gjyqtarëve, që plotësonin kushtet ligjore për t’u përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedhën anëtarë të KED-së, përkatësisht:

- *Znj. Marjana Semini (anëtar)*

⁴² <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Lista-e-kandidateve-e-percjelle-nga-Gjykata-Kushtetuese.pdf>

- *Z. Ilir Toska (anëtar)*

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, por në këtë rast gogla u tërhoq nga punonjësja e Sekretarisë Teknike dhe më konkretisht: *Zj. Marsida Xhaferllari (anëtar zëvendësues)*.

- *Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Lartë* u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të kësaj gjykate, të konfirmuar në listën nominale, të dërguar me shkresën nr. 5254/3 prot., datë 19.11.2024, të kryetarit të KLGJ-së drejtuar Presidentit të Republikës.⁴³ Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Lartë (17 (shtatëmbëdhjetë) kandidatë sipas listës përkatëse), punonjësja e Sekretarisë Teknike të institucionit të Presidentit të Republikës, bëri përzierjen e goglave dhe drejtuesi i procesit teknik të hedhjes së shortit zj. Shia, ftoi një prej përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të ftuara për të ndjekur procedurën e hedhjes së shortit, për të tërhequr në mënyrë rastësore një gogël. Ky përfaqësues tërhoqi goglën përkatëse, nxorri shiritin e letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, lexoi me zë të lartë emrin e kandidatit për të gjithë pjesëmarrësit në sallë dhe më pas ja dorëzoi shiritin e letrës Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 17 (shtatëmbëdhjetë) gjyqtarëve, që plotësonin kushtet ligjore për t'u përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedhën anëtarë të KED-së, përkatësisht:

- *Z. Sokol Sadushi (kryetar)*

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, dhe më konkretisht: *Z. Medi Bici (anëtar zëvendësues)*.

- *Procedura e zhvillimit të shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme* u zhvillua ndërmjet emrave të prokurorëve të kësaj Prokurorie, të konfirmuar në listën nominale (10 (dhjetë) kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme), të përcjellë me shkresën nr. 2599/1, datë 27.11.2024, nga ana e kryetarit të institucionit të KLP-së, drejtuar Presidentit të Republikës.⁴⁴

Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve punonjësja e Sekretarisë Teknike të institucionit të Presidentit të Republikës, bëri përzierjen e goglave dhe drejtuesi i procesit teknik të hedhjes së shortit zj. Shia, ftoi një prej përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të ftuara për të ndjekur procedurën e hedhjes së shortit, për të tërhequr në mënyrë rastësore një gogël. Ky përfaqësues tërhoqi goglën përkatëse, nxorri shiritin e letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, lexoi me zë të lartë emrin e kandidatit për të gjithë pjesëmarrësit në sallë dhe më pas ja dorëzoi shiritin e letrës Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

⁴³ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Lista-e-kandidateve-e-percjelle-nga-KLGJ.pdf>

⁴⁴ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kthim-pergjigjeje-ne-lidhje-me-listat-e-perditesuara-te-kandidateve-nga-KLP.pdf>

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 10 (dhjetë) prokurorëve që plotësonin kushtet ligjore për t'u përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedh anëtar i KED-së: *Znj. Alma Muça (anëtar)*.
Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme, dhe më konkretisht: *Z. Thoma Jano (anëtar zëvendësues)*.

- *Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat e Apelit (Gjykata e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë)* u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve të këtyre gjykatave, të konfirmuar në listën nominale, të dërguar me shkresën nr. 5254/3 prot. datë 19.11.2024, të kryetarit të KLGJ-së drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat e Apelit, punonjësja e Sekretarisë Teknike të institucionit të Presidentit të Republikës, bëri përzierjen e goglave dhe drejtuesi i procesit teknik të hedhjes së shortit zj. Shia, ftoi një prej përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të ftuara për të ndjekur procedurën e hedhjes së shortit, për të tërhequr në mënyrë rastësore një gogël. Ky përfaqësues tërhoqi goglën përkatëse, nxorri shiritin e letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, lexoi me zë të lartë emrin e kandidatit për të gjithë pjesëmarrësit në sallë dhe më pas ja dorëzoi shiritin e letrës Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet 45 (dyzetepesë) emrave të gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për t'u përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedhën anëtar të KED-së:

- *Z. Fuat Vjerdha (anëtar)*
- *Znj. Enkela Vlora (anëtar)*

Me të njëjtën procedurë shorti u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtarë të Gjykatave të Apelit, dhe më konkretisht;

- *Znj. Elvana Çiçolli (anëtar zëvendësues)*

- *Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit*, u zhvillua ndërmjet emrave të prokurorëve, të konfirmuar në listën nominale, të përcjellë me shkresën nr. 2599/1, datë 27.11.2024, nga ana e kryetarit të institucionit të KLP-së, drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit (9 kandidatë sipas listës përkatëse), punonjësja e Sekretarisë Teknike të institucionit të Presidentit të Republikës, bëri përzierjen e goglave dhe drejtuesi i procesit teknik të hedhjes së shortit zj. Shia, ftoi një prej përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të ftuara për të ndjekur procedurën e hedhjes së shortit, për të tërhequr në mënyrë rastësore një gogël. Ky përfaqësues tërhoqi goglën përkatëse, nxorri shiritin e letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, lexoi me zë të lartë emrin e kandidatit për të gjithë pjesëmarrësit në sallë dhe më pas ja dorëzoi shiritin e letrës Sekretariatit Teknik. Kandidati i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 9 (nëntë) prokurorëve që plotësonin kushtet ligjore për t'u përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedhën anëtar i KED-së:

- *Znj. Irma Balli* (anëtar)
- *Z. Etien Kapo* (anëtar)

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, prokuror në Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit, dhe më konkretisht: *Z. Genti Xholi* (anëtar zëvendësues).

- *Procedura e hedhjes së shortit për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat Administrative (Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë)* u zhvillua ndërmjet emrave të gjyqtarëve, të konfirmuar në listën nominale, të dërguar me shkresën nr. 5254/3 prot. datë 19.11.2024, të kryetarit të KLGJ-së drejtuar Presidentit të Republikës. Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykatat Administrative, punonjësja e Sekretarisë Teknike të institucionit të Presidentit të Republikës, bëri përzjerjen e goglave dhe drejtuesja e procesit teknik të hedhjes së shortit zj. Shia, ftoi një nga prej përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të ftuara për të ndjekur procedurën e hedhjes së shortit, për të tërhequr në mënyrë rastësore një gogël. Ky përfaqësues tërhoqi goglën përkatëse, nxorri shiritin e letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, lexoi me zë të lartë emrin e kandidatit për të gjithë pjesëmarrësit në sallë dhe më pas ja dorëzoi shiritin e letrës Sekretariatit Teknik. Kandidati, i përzgjedhur në këto kushte merr cilësinë e anëtarit të KED.

Pas zhvillimit të shortit ndërmjet emrave të 10 (dhjetë) gjyqtarëve që plotësonin kushtet ligjore për t'u përfshirë në short, rezultoi se u përzgjedh anëtar i KED-së: *Znj. Nafije Hasko* (anëtar).

Me të njëjtën procedurë shorti, u zgjodh edhe anëtari zëvendësues i anëtarëve të KED-së, gjyqtar në Gjykatat Administrative, dhe më konkretisht; *Z. Besart Kaçkini* (anëtar zëvendësues)

Sipas përkatësisë së hedhjes së shortit referuar institucionit nga vinin kandidatët garues, për audiencën që ndiqte këtë procedurë shfaqej paraprakisht në një ekran të madh elektronik, lista e kandidatëve të propozuar që plotësonin kushtet ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të KED.

Në përfundim të këtij procesi, u përzgjedhën 9 anëtarë të KED, dhe 6 anëtarë zëvendësues. Sekretaria teknike, përpiloi në prezencë të të gjithë të pranishmëve në sallë proces-verbalin përkatës, i cili u firmos po në prezencë të të pranishmëve nga Presidenti i Republikës.

Në përputhje me pikën 6, të nenit 284, të ligjit nr.115/2016, “*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*”, në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës, menjëherë pas përfundimit të procesit të hedhjes së shortit, u publikuan :

1. Shpallja e rezultatit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2025 (nënshkruar nga Presidenti i Republikës)⁴⁵

⁴⁵ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/12/Shpallja-e-rezultatit-pas-hedhjes-se-shortit-nga-Preidenti-i-Republikes-sot-me-2-dhjetor-2024.pdf>

2. Procesverbali për hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për vitin 2025⁴⁶.

Hedhja e shortit u transmetua direkt nga ana e Televizionit Publik Shqiptar, i cili ishte ftuar zyrtarisht me shkresë,⁴⁷ ndërkohë që kishte edhe disa media të tjera, të cilat qëndruan prezent gjatë gjithë procedurës dhe transmetuan pjesërisht drejtëpërdrejt këtë procedurë shorti.

Në përfundim të hedhjes së shortit, u shpallën emrat e anëtarëve të KED 2025, të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, si vijon:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për vitin 2024:

- | | | |
|------------------------|---|-----------|
| 1. Z. Sokol Sadushi | nga Gjykata e Lartë | - Kryetar |
| 2. Znj. Marjana Semini | nga Gjykata Kushtetuese | - Anëtar |
| 3. Z. Ilir Toska | nga Gjykata Kushtetuese | - Anëtar |
| 4. Z. Alma Muça | nga Prokuroria e Përgjithshme | - Anëtar |
| 5. Z. Fuat Vjerdha | nga Gjykatat e Apelit | - Anëtar |
| 6. Znj. Enkela Vlora | nga Gjykatat e Apelit | - Anëtar |
| 7. Znj. Irma Balli | nga Prokuroria e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm | - Anëtar |
| 8. Z. Etien Kapo | nga Prokuroria e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm | - Anëtar |
| 9. Znj. Nafije Hasko | nga Gjykata Administrative | - Anëtar |

Anëtarët zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:

- | | |
|-----------------------------|---|
| 1. Znj. Marsida Xhaferllari | nga Gjykata Kushtetuese |
| 2. Z. Medi Bici | nga Gjykata e Lartë |
| 3. Z. Thoma Jano | nga Prokuroria e Përgjithshme |
| 4. Znj. Elvana Çiçolli | nga Gjykata e Apelit |
| 5. Z. Genti Xholi | nga Prokuroria e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm |
| 6. Z. Bezart Kaçkini | nga Gjykata Administrative. |

Procedura e shortit filloi në orën 09:00 dhe përfundoi në orën 10:05.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

⁴⁶ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/12/Procesverbali-i-rezultatit-te-shortit-KED-2025.pdf>

⁴⁷ <https://president.al/wp-content/uploads/2024/11/Kerkese-per-grup-xhirimi.pdf>